

VENDIM
Nr. 389, datë 12.6.2019

PËR KRITERET PËR LËSHIMIN E PASAPORTËS DIPLOMATIKE DHE ASAJ TË SHËRBIMIT

(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 24.12.2019, nr. 510, datë 1.7.2020, nr. 1078, datë 24.12.2020; nr. 54, datë 1.2.2021)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8668, datë 23.11.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pasaportat diplomatike dhe të shërbimit u lëshohen personave që u lind kjo e drejtë sipas parashikimeve ligjore apo nga ky vendim.

2. Për qëllime të këtij vendimi, “Pasaportë diplomatike apo shërbimi” është dokumenti i udhëtimit që vërteton identitetin dhe shtetësinë shqiptare të mbajtësve të saj dhe që lëshohet për kategoritë e përcaktuara në lidhjen 1 “Pasaportat diplomatike” dhe lidhjen 2 “Pasaportat e shërbimit”, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Në rastin kur mbajtësi i pasaportës diplomatike apo Shërbimit lë funksionin për të cilin është pajisur me këtë pasaportë, ajo duhet të dorëzohet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike pranë ministrisë përgjegjëse për Punët e Jashtme, me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

4. Institucionet publike njoftojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dorëzimi i detyrës, ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme për datën dhe emrin e subjektit që ka lënë funksionin, për të cilin është pajisur me pasaportë diplomatike apo shërbimi.

5. Pasaportat, të cilat nuk dorëzohen sipas afatit të përmendur në pikën 3, shpallen të pavlefshme nga ministria përgjegjëse për Punët e Jashtme.

6. Për pasaportat diplomatike apo të shërbimit të shpallura të pavlefshme sipas pikës 5, të këtij vendimi, ministria përgjegjëse për punët e jashtme njofton brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike të gjitha misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë të akredituara jashtë vendit dhe misionet e huaja të akredituara në Republikën e Shqipërisë për pavlefshmërinë e pasaportës së padorëzuar.

7. Njoftimi i përmendur në pikën 6 i përcillet, gjithashtu, Departamentit për Kufirin e Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, i cili urdhëron të gjitha pikat e kalimit kufitar për moslejimin e daljes jashtë shtetit të mbajtësit të pasaportës diplomatike apo të shërbimit, për bllokimin e pasaportës dhe kthimin e saj në ministrinë përgjegjëse për Punët e Jashtme.

8. Në rastin kur mbajtësi i pasaportës diplomatike apo të shërbimit e humbet atë gjatë periudhës, gjatë së cilës e gëzon këtë të drejtë, ripajiset me pasaportë të re, vetëm pasi institucioni përkatës ta ketë dërguar në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme:

- a) kërkesën për ripajisjen me pasaportë diplomatike ose shërbimi;
- b) deklaratën e personit ku sqaron rrethanat e humbjes;
- c) denoncimin pranë autoritetit përgjegjës në Ministrinë e Brendshme ku të jetë konfirmuar se humbja e kësaj pasaporte iu është bërë e njohur të gjitha pikave të kalimit kufitar;

ç) denoncimin para autoritetit përgjegjës në shtetet e tjera ose misionin diplomatik apo konsullor të Republikës së Shqipërisë në një shtet tjetër për humbjen/vjedhjen e kësaj pasaporte.

9. Ngjyra e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit është e ndryshme nga ajo e pasaportave të zakonshme.

10. Format i ekzistues i pasaportës diplomatike dhe shërbimit është i vlefshëm deri në datën *31 dhjetor 2022*.

11. Procedura dhe dokumentet që paraqiten për aplikim për pasaportë diplomatike apo shërbimi përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për Punët e Jashtme.

12. Institucionet publike mbulojnë nga buxheti i tyre kostot për pajisjen me pasaportat diplomatike apo të shërbimit të funksionarëve të tyre.

13. Vendimi nr. 335, datë 2.9.1997, i Këshillit të Ministrave, “Për pajisjen me pasaporta diplomatike dhe shërbimi”, dhe aktet e tjera ndryshuese në zbatim të tij shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

14. Subjektet, që janë pajisur me pasaporta diplomatike apo shërbimi përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë të drejtë të përdorin pasaportat përkatëse deri më datë *30 qershor 2021*.

15. Ngarkohen ministria përgjegjëse për Punët e Jashtme, ministria përgjegjëse për Punët e Brendshme dhe institucionet e tjera publike, zyrtarët apo subjektet e të cilave pajisen me pasaporta diplomatike apo shërbimi sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LIDHJA 1

Pajisen me pasaporta biometrike diplomatike subjektet e mëposhtme:

1. Presidenti;
2. Ish-Presidenti;
3. Kryetari Kuvendit;
4. Ish-Kryetari i Kuvendit;
5. Kryeministri;
6. Ish-Kryeministri;
7. Bashkëshortja/i e/i dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeç të:
 - a) Presidentit;
 - b) Kryetarit të Kuvendit;
 - c) Kryeministrit.
8. Bashkëshortja/i e/i deputetit;
9. Zëvendëskryeministri;
10. Anëtarët e Këshillit të Ministrave;
11. Deputeti;
12. Zëvendësministri;
13. Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese;
14. Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë;
15. Drejtuesi dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ);
16. Drejtuesi dhe anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP);

17. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;
18. Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
19. Komisionerët Publikë;
20. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
21. Kryetari dhe anëtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;
22. Avokati i Popullit;
23. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
24. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ);
25. Drejtuesi dhe anëtarët e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK);
26. Prokurori i Përgjithshëm;
27. Sekretari i Përgjithshëm në institucionin e Presidentit, Kuvend, Kryeministri;
28. Drejtori i kabinetit në institucionin e Presidentit, Kuvend, Kryeministri, ministrinë përgjegjëse për Punët e Jashtme;
29. Këshilltarët në kabinetin e institucionit të Presidentit, Kuvend, Kryeministri, në rastet kur janë të ngarkuar me çështje diplomatike dhe protokollare, jo më shumë se tre këshilltarë për secilin institucion;
30. Këshilltarët e ministrit përgjegjës për punët e jashtme, kur janë diplomatë karriere;
31. Kryetari dhe nënkryetari i Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH);
32. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK);
33. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit;
34. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë;
35. Personeli diplomatik i Shërbimit të Jashtëm dhe familjarët e tyre, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë;
36. *Funksionarët ndërkombëtarë, përfaqësues ose anëtarë të organizatave ndërkombëtare me shtetësi shqiptare, të emëruar, të kandiduar nga shteti shqiptar ose që përfaqësojnë interesat e shtetit shqiptar në këto organizata;*
37. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;
38. Oficeri i Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësues i Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare dhe familjarët e tyre, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë;
39. Oficer kontakti pranë ministrive homologe të shteteve të tjera, institucioneve ndërkombëtare, si dhe të atashuar pranë misionëve diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe familjarët e tyre, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë;
40. Korrieri diplomatik;
41. Komandanti i Gardës së Republikës;
42. Trup-rojë për sigurimin e:
 - a) Presidentit;
 - b) Kryetarit të Kuvendit;
 - c) Kryeministrit.
43. Personat që me ligj të posaçëm gëzojnë të drejtën për pajisjen me pasaportë diplomatike.
44. *Funksionarët dhe nëpunësit publikë, me miratimin e ministrit përgjegjës për punët e jashtme, për shkak të specifikës së funksionit apo të detyrës shtetërore që kryejnë.*

LIDHJA 2

Pajisjen me pasaporta biometrike shërbimi, subjektet e mëposhtme:

1. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë;

2. Inspektori i Përgjithshëm i ILKPD-së;
3. Sekretari i Përgjithshëm në ministri dhe institucionet kushtetuese, të cilët nuk janë parashikuar në lidhjen 1;
4. Drejtori i kabinetit pranë Zëvendëskryeministrit, në ministri dhe institucionet kushtetuese, të cilët nuk janë parashikuar në lidhjen 1;
5. Drejtorët e departamentit në Kryeministri;
6. Kryetari i bashkisë;
7. Prefekti;
8. Zëvendësprokurori i Përgjithshëm;
9. Drejtori i Radiotelevizionit Shqiptar;
10. Kryetari i Akademisë së Shkencave;
11. Kryetari i Komunitetit Mysliman;
12. Kryetari i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane;
13. Kryetari i Konferencës Ipeshkvore;
14. Kryetari i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare;
15. Kryetarët e partive politike;
16. Asistent/ndihmës, kameraman dhe fotograf i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit;
17. Personat që me ligj të posaçëm gëzojnë të drejtën për pajisjen me pasaportë shërbimi.
18. *Funksionarët dhe nëpunësit publikë, me miratimin e ministrit përgjegjës për punët e jashtme, për shkak të specifikës së funksionit apo detyrës shtetërore që kryejnë.*